



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-85

Prishtinë, më 1 dhjetor 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 1 DHJETOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviç dhe Myfera Shinik, anëtarë të Kryesisë.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Lulzim Zeneli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, Skënder Reçica dhe Ilir Gashi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga NDI, Rinor Beka,
Nga OSBE, Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe një pikë shtesë:

- Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni.

Kryesia miratoi propozimin e kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 nëntor 2009,
2. Propozimi i rendi të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave,

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 nëntor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 17 nëntor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendi të ditës për seancën plenare, më 4 dhjetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e ardhshme plenare të mbahet më 4 dhjetor 2009, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e

- 2.1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
- 2.2. Koha për pyetje parlamentare,
- 2.3. Shqyrtimi i parë Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
- 2.4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping

- 2.5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme të parapagimit të RTK-së (pas konsultimit shtesë me komisionin funksional).

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i Propozim - Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit

Me propozimin e anëtarit të Kryesisë, Nexhat Daci, kjo pikë u shty për një mbledhje tjetër, me arsyetimin se paraprakisht duhet të miratohet Rregullorja e re e Punës së Kuvendit, pastaj Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme për parapagimin e RTK-së

Kryetari tha se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme, për parapagimin e RTK-së dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Sabri Hamiti tha se lidhur me rekomandimin numër tre të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, atë të planit financiar të RTK-së për pagesën gjashtë-mujore, do të ishte mirë të jepet një afat deri kur do të bëhej kjo.

Naim Maloku propozoi që Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media të kërkojë planin financiar nga RTK-ja dhe pasi të arrijë ky plan në Kuvend, më pas kjo pikë të radhitet për seancë plenare.

Ramë Buja tha se Rekomandimet e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, sikur nuk mund të shkojnë bashkë që të tria.

Nexhat Daci tha se lidhur me financimin në RTK-së është mirë të mos marrim vendime politike.

Ibrahim Gashi tha se nuk ka kundërthënie në mes të Rekomandimeve të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, përpos që rekomandimi numër tre mund të bëhej numër dy dhe anasjelltas.

Kryetari konstatoi se ai do të ketë një takim me kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media dhe me kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me këtë çështje dhe, varësisht nga ky takim, kjo pikë mund të radhitet për seancën plenare të 4 dhjetorit 2009.

3.3 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave

Kryesia, pasi shqyrtoi pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Rekomandimi i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 03/71, dt. 03.07.2009, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të hekurudhave në Republikën e Kosovës, t'i dërgohet Qeverisë për veprime të mëtejme.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor lidhur me procedimin e Projektligjit për organizmat e modifikuara gjenetikisht

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor duhet të konsultohet me përfaqësuesit e ICO-s dhe të USAID-it për procedimin e Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimet lidhur me të.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturere lidhur me funksionalizimin e këtij Këshilli,

Kryetari tha se kjo pikë e rendit të ditës konsumohet bashkë me pikën 3.6 pas Rekomandimit që Komisioni për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport e ka dërguar me datë 30 nëntor 2009.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturere për rishqyrtimin e Përfundimit të Kryesisë, nr. 03-P- 169/K

Kryesia, pasi shqyrtoi pikat 3.5 dhe 3.6 të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

1. Kryesia mbështet Rekomandimet e Komisionit për Arsim, Shkencë Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, lidhur me kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturere.
2. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset sekretari i Kuvendit.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e udhëtimit në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa: Gani Koci, Naser Oamani, Kosara Nikoliq, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Suzan Novobërdaliu, Besa Gaxherri, Mufëra Shinik dhe Xhevdet Neziraj, si dhe të dy zyrtarëve të Administratës së Kuvendit: Natasha Tishma dhe Vilson Ukaj, në Republikën e Shqipërisë nga data 2-5 dhjetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, kurse mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shëndetësi për lejimin e udhëtimit në Bullgari

Kryesia, pasi shqyrtoi pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Qamile Morina, Teuta Hadri, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Shpresa Haxhijaj, në Parlamentin e Bullgarisë, prej 01 deri më 04 dhjetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

3.9 Njoftim me Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim për nivelizimin e pagave për stafin e KPMT-së

Kryesia u njoftua me Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për nivelizimin e pagave të stafit të KPM-së.

Pika shtesë:

- **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për lehtësimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni**

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media: Melihate Tërmkollli, Hajdin Abazi, Dragan Dimiq, si dhe të stafit mbështetës të Komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Kimete Cimili në Maqedoni, prej 05 deri më 08 dhjetor 2009.
2. Shpenzimet e qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale